



Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Plani Strategjik 2016 – 2018

Nëntor 2015

Përgatiti: Komiteti Shqiptar i Helsinkit me ndihmën e ekspertes Delina Fico

Përktheu:

Dizajnoi:

Printoi:

Nëse jeni të interesuar për këtë botim, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. "Brigada e VIII", Ap. 10, Kati 5.
Kutia Postare 1752
Tirana-Albania
Tel.&Fax: +355 4 22 33 671
Web site: www.ahc.org.al

Ky dokument u realizua me mbështetjen financiare të Civil Rights Defenders.

Tryeza e lëndës

I. Hyrja

II. Organizata

- a. Historia
- b. Organizimi, stafi dhe asetet
- c. Aktivitetet dhe shërbimet
- d. Organizatat partnere
- e. Arritjet kryesore gjatë viteve 2013 – 2015

III. Konteksti politik, ekonomik dhe shoqëror

IV. Drejtimi strategjik

- a. Vizioni
- b. Misioni
- c. Vlerat
- d. Përparësitë konkurruese

V. Objektivat strategjike dhe programet për vitet 2016 – 2018

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

I. Hyrja

Ky dokument paraqet Planin Strategjik të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) për periudhën trevjeçare 2016 – 2018. Plani Strategjik i KSHH:

- bazohet mbi një analizë të zhvillimeve kryesore politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në Shqipëri, në Evropën Juglindore, në pjesën tjetër të Evropës dhe në botë, zhvillime që mund të kenë ndikim në fushën e të drejtave të njeriut e, për pasojë, edhe në punën e KSHH në tri vitet e ardhshme;
- reflekton një rivlerësim të vizionit, misionit, dhe vlerave, mbi të cilat bazohet puna e KSHH;
- parashtron objektivat strategjike të KSHH për periudhën 2016 – 2018 dhe programet që KSHH do të vërë në jetë për të arritur këto objektiva strategjike; si dhe
- përvijon disa ndryshime në qasjen e KSHH për të rritur efektivitetin e punës për zbatimin e këtij plani.

Plani Strategjik do të udhëheqë punën e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, Bordit Drejtues dhe stafit të KSHH për tri vitet e ardhshme. Ai do të shërbejë si dokument reference edhe për bashkëpunëtorët, institucionet e organizatat partnere, si dhe donatorët e KSHH.

Plani Strategjik reflekton: (i) diskutimet dhe idetë e shkëmbyera gjatë Seminarit për Planifikimin Strategjik të KSHH, i cili u zhvillua në qershor 2015 me pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve me kohë të plotë të KSHH; (ii) idetë, faktet dhe mësimet e nxjerra nga shqyrtimi i një sërë dokumentesh me rëndësi për veprimtarinë e KSHH, si, p.sh., raporte vjetore dhe vlerësime të mëparshme të organizatës; (iii) diskutimet dhe sugjerimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe Bordit Drejtues të KSHH mbi varjantin e parë të Planit Strategjik; (iv) një diskutim përfundimtar të planit me drejtuesit e KSHH; si dhe (v) rezultatet e një vlerësimi të punës së KSHH në tri vitet e fundit, vlerësim, në të cilin morën pjesë përfitues të punës së KSHH, bashkëpunëtorë të jashtëm, si dhe partnerë nga institucione shtetërore apo organizata jofitimprurëse. KSHH angazhoi znj. Delina Fico si eksperte për të ndihmuar në procesin e përgatitjes së këtij Plani Strategjik.

II. Organizata

a. Historia


Në 16 dhjetor 1990, në kontekstin e valës së parë të lëvizjeve për transformimin demokratik të Shqipërisë, një grup intelektualësh publikë themeluan Forumin Shqiptar për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, i cili më vonë u emërtua “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” (KSHH). KSHH u themelua që në krye të herës si një organizatë me anëtarësi dhe si një subjekt jofitimprurës, joqeveritar dhe jopartiak. Organizata u fokusua fillimisht në të drejtat e personave të persekutuar nga regjimi totalitar, që sundoi Shqipërinë në gjysmën e dytë të shekullit XX, dhe luajti rol udhëheqës në edukimin e shoqërisë shqiptare lidhur me kuadrin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Në 22 mars të vitit 1992 KSHH u bë anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, me qendër në Vjenë. Në këtë çerek shekulli, KSHH ka qenë dhe mbetet organizata më në zë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, si dhe një partner kryesor për organizatat e tjera joqeveritare, institucionet publike shqiptare, agjenci dhe programe ndërkombëtare që punojnë për përparimin e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

b. Organizimi, stafi dhe asetet

Organi më i lartë drejtues i KSHH është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, e përbërë nga 14 anëtarë (aktualisht 2 gra e 12 burra), e cila zgjedh Bordin Drejtues. Ky Bord përbëhet nga 5 anëtarë (aktualisht 1 grua dhe 4 burra) dhe funksionon si organ vendim-marrës mes dy mbledhjeve të Asamblesë. Puna e KSHH drejtohet nga Drejtori/ja Ekzekutiv/e (aktualisht grua), i cili/e cila zgjidhet nga Bordi Drejtues. KSHH punëson aktualisht 8 persona me kohë të plotë (shiko organogramën më poshtë) dhe, sipas nevojave të projekteve, punëson me kohë të pjeshme ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët i përzgjedh nga grupi i bashkëpunëtorëve dhe aktivistëve të trajnuar e kualifikuar të organizatës (rreth 200 bashkëpunëtorë, nga të cilët 150 janë të specializuar në monitorimin e zgjedhjeve). KSHH ka ngritur, po ashtu, një rrjet me 7 korrespondentë (të punësuar me kohë të pjeshme) me banim në Kukës, Gjirokastrë, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan, dhe Shkodër (3 gra dhe 4 burra). Ky rrjet bashkëpunëtorësh vëzhgon dhe monitoron respektimin e të drejtave të njeriut në rrethet përkatëse dhe luan rolin e organizatorit në zbatimin e nismave e aktiviteteve të KSHH në këto rrethe.

KSHH ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë Shqipërinë, por selia e organizatës është e vendosur në Tiranë. KSHH ka kontraktuar me qera mjedisin që përdor për zyrat e punës, dhe ka në pronësi të tij vetëm pajisjet e nevojshme elektronike dhe të zyrës, si dhe një autoveturë.

Tabela 1: Organograma e KSHH¹



¹Korrespondentët e KSHH i raportojnë Drejtores Ekzekutive ose njërit prej Drejtorëve të Programeve, varësisht nga projekti, në të cilin angazhohen.

c. Aktivitetet dhe shërbimet

KSHH zhvillon llojet e aktiviteteve të paraqitura në vijim për të arriturë qëllimet e tij strategjikë:

- **Mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave** lidhur me të drejtat e njeriut në formën e raporteve vjetore apo tematike, monitorimeve dhe vëzhgimeve në emër të opinionit publik, apo studimeve të thelluara për çështje konkrete të fushës së të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës;
- **Edukim dhe sensibilizim i publikut dhe i administratës publike** lidhur me çështje të caktuara të të drejtave të njeriut, që përfshin leksione e diskutime në institucione publike, jofitimprurëse, private dhe akademike; fushata të ndërgjegjësimit publik përmes mediave tradicionale dhe atyre sociale; si dhe kontribute të përfaqësuesve të KSHH në debatin publik në këto media;
- **Avokim** për çështje në fushën e veprimtarisë së KSHH që përfshin që nga vlerësimi i nevojave e rrjetëzimi me partnerë të tjerë të interesuar deri në takime me vendim-marrës dhe prezantim të propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve konkrete lidhur me nisma ligjbërëse apo politika e programe publike konkrete;
- **Mbajtja e qëndrimeve publike** lidhur me çështje urgjente të të drejtave të njeriut përmes deklaratave dhe konferencave për media;
- **Ofrimi ndihmës teknike** për organe ligjvënëse dhe institucione të tjera publike për probleme që lidhen me misionin e KSHH, që përfshin diskutime, këshilla, dhe ofrim të propozimeve konkrete të përgatitura nga ekspertët e KSHH;
- **Trajnim dhe ngritje kapacitetesh** për institucionet publike, jofitimprurëse, private dhe akademike lidhur me të drejtat e njeriut;
- **Ofrim i ndihmës ligjore falas** për viktime të shkeljes së të drejtave të njeriut (përmes Klinikës Ligjore të KSHH) që përfshin ndjekjen e rasteve individuale në të gjitha shkallët e sistemit të drejtësisë shqiptare deri në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

d. Organizatat partnere

KSHH bashkëpunon dhe bashkërendon punën e tij me organizata të shoqërisë civile, institucione publike, si dhe me programe e organizma bilateralë, multilateralë, apo privatë ndërkombëtarë që veprojnë në fushën e mbrojtjes, promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Edhe pse disa prej këtyre organizatave mund të jenë konkurrentë me KSHH në një farë mase dhe për çështje të caktuara, KSHH ndjek gjithnjë linjën e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit me ta. Ndërkaq, KSHH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione kryesore publike.

KSHH është anëtare e: Rrjetit të Klinikave Ligjore Falas në Shqipëri; Rrjetit Shqiptar të Organizatave për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; Platformës së Solidaritetit të Shoqërisë Civile pranë Këshillit të Europës, si dhe të Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Ballkan që buron nga kjo Platformë.

Organizatave e institucionet kryesore, me të cilat KSHH bashkëpunon më së shumti janë si vijon:

i. *Institucione publike:*

- Parlamenti i Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi; Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin;
- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Burgjeve,
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Mjedisit;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- Kontrolli i Lartë i Shtetit;
- Avokati i Popullit, Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Bashkitë Tiranë, Lezhë, Korçë, Gjirokastër, Fier, dhe Elbasan, Kukës, Vlorë, Shkodër etj

ii. *Organizatave e shoqërisë civile:*

- Qendra e Nismave Ligjore Qytetare, ResPublica, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Rehabilitimin e Torturës dhe Traumës, TILAS, Instituti European i Tiranës, Shtëpia e të Drejtave të Njeriut, shoqata “Përthyerja”, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut;
- Rrjeti Shqiptar kundër Dhunës Gjinore dhe Trafikimit;
- Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF) dhe rrjeti i organizatave që ADRF bashkërendon;
- Aleanca kundër Diskriminimit të Personave LGBT dhe ProLGBT Shqipëri;
- Partners Albania; shoqata “Eden”;
- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

- Shoqata “Romët për Integrim” dhe shoqata të tjera që mbrojnë të drejtat e komunitetit rom.
- iii. *Institucione akademike:* Universiteti i Tiranës, Universiteti “Marin Barleti, Universiteti “Luarasi”; Universiteti “Ismail Qemali “ Vlore, Universiteti “F.Noli” Korçe,
- iv. *Programe dhe organizata ndërkombëtare:*
- Misioni i OSBE-së në Tiranë;
 - OSBE/ODHIR;
 - Agjencitë e OKB-së në Tiranë;
 - Delegacioni i BE-së në Shqipëri;
 - KRCT (Kati, Kosovë)
 - Komiteti i Helsinkit në Hollandë, Norvegji, Suedi, Zvicër, Maqedoni, Poloni, Greqi, Serbi, Bullgari
 - In Lande Person (projekt i BE-së).

Donatorët kryesorë që kanë përkrahur punën e KSHH në tri vitet e fundit janë: Civil Rights Defenders; Delegacioni i BE-së në Shqipëri; Këshilli i Europës; Open Society Institute - Budapest; Fondacioni për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri (OSFA); UNICEF; National Endowment for Democracy (NED), Ambasadat e Hollandës, e Zvicrës dhe e SHBA-ve në Tiranë.

e. Arritjet kryesore gjatë viteve 2013 – 2015

Tri vitet e fundit shënuan një periudhë angazhimi intensiv të KSHH në disa çështje prioritare për të drejtat e njeriut në Shqipëri. Paraqesim në vijim disa nga veprimtaritë dhe arritjet kryesore të KSHH gjatë këtyre tri viteve, të cilat e konsoliduan rolin e KSHH si një institucion autoritar, i besueshëm dhe i pavarur që mbron e promovon garantimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Përgatitja e Raportit Vjetor mbi Situatën e Respektimit të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri.

KSHH përgatiti e bëri publike tri raporte të tilla gjatë periudhës 2013 - 2015. Ky Raport Vjetor i KSHH, i vetmi i këtij lloji në Shqipëri, ofron një pasqyrë të detajuar të përparimeve dhe sfidave lidhur me të drejtat e njeriut në vend, si dhe parashtron vlerësimin dhe kontributin e KSHH për çështje të caktuara që kanë marrë përparësi gjatë vitit, për të cilin raportohet. Raportet Vjetore të KSHH për vitin 2012, 2013, dhe 2014 vazhduan të shërbejnë si burim informacioni (i cituar, në më të shumtën e herës) për seksionin për Shqipërinë të Raportit të Departamentit të Shtetit

Amerikan për të Drejtat e Njeriut, për Raportin e Progresit të BE për Shqipërinë, si dhe për botime e studime të tjera lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin tonë apo për nisma monitorimi e avokimi që lidhen me to.

Monitorimi i zgjedhjeve të përgjithshme (qershor 2013) dhe ato për pushtetin vendor (qershor 2015). Bazuar mbi përvojën e tij të gjatë dhe të suksesshme në monitorimin e zgjedhjeve dhe në bashkërendim me shoqata e grupime të tjera që monitorojnë zgjedhjet në Shqipëri, KSHH monitoroi zgjedhjet e përgjithshme dhe ato për pushtetin lokal përmes rrjetit të tij të vëzhguesve. KSHH përgatiti dhe bëri publik raporte paraprake dhe raportin përfundimtar të monitorimit të zgjedhjeve, si dhe deklarata ndërmjetëse, duke nxjerrë në pah mangësitë në përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve nga perspektiva e të drejtave të njeriut, si dhe ofroi rekomandime konkrete për t'i adresuar këto mangësi gjatë zgjedhjeve në fjalë ose/dhe në zgjedhjet e ardhshme.

Kontribut në përmirësimin e kuadrit ligjor për disa çështje të rëndësishme. Gjatë këtyre tri viteve, KSHH kontribuoi në mënyrë të rëndësishme në diskutimet publike dhe ato me grupe ekspertësh të organizuara nga institucionet publike përkatëse dhe/ose nga Parlamenti. KSHH paraqiti propozime konkrete për disa ligje të rëndësishme, duke përfshirë ligjin “Mbi të drejtën për informim”, “Mbi njoftimin dhe konsultimin publik”, “Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara”, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, “Për ndihmën ligjore”, “Për Policinë e Shtetit”, “Për Avokatin e Popullit”, për rezolutën “Mbi njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimit demokratik të vendit”, si dhe për amendimin e Kodit Penal dhe të ligjeve “Për Policinë e Burgjeve”, “Për Kontrollin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë”, “Për emergjencat mjekësore”, etj. Një pjesë e rëndësishme e rekomandimeve kryesore të KSHH u përfshinë në varjantin përfundimtar të shumë prej këtyre ligjeve dhe rezolutave.

Kontribut në reformën e sistemit të drejtësisë. Gjatë vitit 2015, KSHH kontribuoi në mënyrë të rëndësishme dhe aktive në diskutimin dhe përmirësimin e analizës së sistemit të drejtësisë dhe të paketës së propozimeve për ndryshime në organizmin dhe funksionimin e këtij sistemi, të përgatitura nga grupi i ekspertëve vendas dhe të huaj në suazën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Studimet dhe raportet e KSHH për sistemin e drejtësisë dhe për Policinë e Shtetit u përfshinë në raportin mbi Analizën e Sistemit të Drejtësisë që u përgatiti nga ky Komision. Duke e vlerësuar reformën në drejtësi si një moment madhor me

ndikim potencialisht të jashtëzakonshëm në zgjerimin e hapësirave për zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të çrrënjësjes së korrupsionit në Shqipëri, KSHH ka monitoruar dhe vazhdon të monitorojë ecurinë e kësaj reforme dhe është bashkë-nismëtare e grupit të organizatave të shoqërisë civile, të cilat monitorojnë zhvillimin e reformës.

Mbrojtja me sukses e viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut. Gjatë viteve 2013 – 2015, Klinika Ligjore e KSHH u ofroi shërbim ligjor falas viktimave të shkeljes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, nëpërmjet ndjekjes së 16 çështjeve gjyqësore, të përzgjedhura në kuadër të litigimit strategjik. Gjithashtu KSHH ka trajtuar 1.076 ankesa, për të cilat ofroi 567 këshillime ligjore, kreu 529 verifikime, asistoi në 72 seanca gjyqësore, ka bërë 16 reagime publike, si dhe ka ndërhyrë në 478 raste pranë administratës publike e private. Duke ju dhënë përparësi rasteve, të cilat krijojnë precedent për zgjerimin e zbatimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në vend, KSHH arriti një sukses të rëndësishëm në rastin *Lika Laska kundër Shqipërisë*. KSHH e ndoqi këtë rast në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe më pas e paraqiti para Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Kjo Gjykatë vendosi në favor të zotërinjve Lika e Laska. KSHH ndoqi në vijim një qasje novatore (që përfshiu angazhimin si *amicus curiae* të dy ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Strasburgut) duke e bërë të zbatueshëm këtë vendim të Gjykatës së Strasburgut në vend, nëpërmjet çarjes së një praktike të re gjyqësore, nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Lartë. Me këtë rast, KSHH krijoi një model për përdorimin më efektiv të Gjykatave në mbrojtje të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Gjatë periudhës 2013 – 2015 KSHH shënoi arritje të vyera edhe në disa nga programet e tjera të saj, si ai i *monitorimit të burgjeve dhe institucioneve të paraburgimit* dhe hartimit të raporteve me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, rritja e kapacitetve të punonjësve në këto institucione në drejtim të zbatimit të eigjislacionit dhe për të respektuar më mirë të drejtat e njeriut. Gjatë kësaj periudhe, KSHH lançoi, po ashtu, disa nisma të reja në fushën e të drejtave sociale dhe ekonomike, të cilat synon t'i zhvillojë më tej në vitet në vijim.

III. Konteksti politik, ekonomik, shoqëror

Suksesi i punës së KSHH në të tri vitet e ardhshme do të varet në një shkallë të lartë nga konteksti politik, ekonomik dhe shoqëror, në të cilin KSHH vepron, dhe nga aftësia e KSHH për të përfituar nga mundësitë që do të krijohen për të çuar përpara kauzën e të drejtave të njeriut në kuadër të këtij konteksti. Ndaj faktorët e zhvillimet e paraqitura në vijim janë parë nga perspektiva e ndikimit të tyre në mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri gjatë periudhës 2016 – 2018.

Ecuria e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Tri vitet e ardhshme do të jenë vendimtare për integrimin e Shqipërisë në BE, duke qenë se gjatë këtyre viteve pritet që BE të caktojë datën për hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në të. Të gjitha partitë

politike në Shqipëri janë shprehur në përkrahje të procesit të integrimit të Shqipërisë në BE. Ndaj është e pritshme që, pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, procesi i integrimit të Shqipërisë në BE të vazhdojë të thellohet. Është, po ashtu, e pritshme që BE të caktojë datën për hapjen e negociatave me Shqipërinë së paku brenda vitit 2018.

Procesi i integrimit të vendit në BE do të vazhdojë të jetë dominant në përcaktimin e axhendës politike të qeverisjes së vendit. Për këtë arsye, është e pritshme që gjatë viteve 2016 – 2018 në Shqipëri të thellohen disa reforma dhe procese që janë pjesë e përpjekjeve të Shqipërisë për të plotësuar standardet e anëtarësimit në BE. Këto reforma e procese përfshijnë:

- Thellimin e zgjerimin e reformës në drejtësi;
- Konsolidimin e administratës publike dhe përmirësimin e performancës së saj;
- Përshkallëzimin e luftës kundër korrupsionit.
- Pastrimin e institucioneve politike nga lidhjet me krimin ('dekriminalizimi' dhe rezultate konkrete në drejtim të luftimit të kriminalitetit);
- Përmirësimin e standardeve për të drejtat e njeriut.

Hapja e negociatave për pranimin e Shqipërisë në BE, kushtëzohet nga përmbushja e plotë e 5 prioritetëve si vijon:

1. Krijimi i një administrate profesionale dhe të depolitizuar
2. Forcimi i pavarësisë të institucioneve të drejtësisë
3. Lufta kundër korrupsionit
4. Lufta kundër krimit të organizuar
5. Mbrojtja e të drejtave të njeriut

(Sipas rekomandimeve të BE në tetor 2013)

Reforma në drejtësi. Kjo reformë, e nisur prej më se një dekade, është përshpejtuar e përshkallëzuar gjatë vitit 2015. Një draft i programit të reformës, i cili përmbledh propozimet kryesore për ndërhyrjet kyçe në sistemin e drejtësisë, u dërgua për mendim në Komisionin e Venecias në tetor 2015, së bashku me disa propozime konkrete për amendime të Kushtetutës. Në kuadër të kësaj reforme, tri vitet e ardhshme pritet të shënojnë ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor themelor të Shqipërisë (duke filluar me Kushtetutën), në organizmin e sistemit të drejtësisë, si dhe në mënyrën e ndërveprimit të sistemit të drejtësisë me sektorët e tjerë të shtetit dhe me qytetarët. Të gjitha këto procese ofrojnë mundësi të gjera dhe sfida të shumta për zgjerimin e gamës, përmirësimin e standardeve dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në vend.

Reforma në administratën publike qendrore dhe vendore. Ligji i ri për administratën publike, i cili hyri plotësisht në veprim në vitin 2014, siguron një qëndrueshmëri më të lartë të administratës ndaj ndërhyrjeve partiake dhe ndryshimeve pas-zgjedhore. Ky proces zgjeron mundësitë për krijimin e konsolidimin e një administrate publike më profesionale. Ndërkohë, pas zgjedhjeve për pushtetin vendor, në vitin 2015, Shqipëria hyri në një proces të gjerë të reformës së pushtetit vendor: u krijuan 61 bashki të reja (në vend të 373 njësive të pushtetit vendor) dhe këto bashki pritet të marrin gjithnjë e më shumë kompetenca në shërbim të qytetarëve. Ky proces decentralizmi i mëtejshëm do të krijojë dinamika të reja lidhur me respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, në mënyrë të veçantë lidhur me të drejtat social-ekonomike, por jo vetëm.

Lufta e vazhdueshme me korrupsionin. Është e pritshme që lufta kundër korrupsionit të përshkallëzohet në tri vitet e ardhshme në Shqipëri, falë presionit të procesit të integritetit në BE, si dhe të qytetarëve, të cilët janë të lodhur nga më shumë se dy dekada të korrupsionit masiv. Por, korrupsioni mund të mbetet sfida më e madhe, me të cilën do të përballet shoqëria shqiptare në përpjekjet e saj për t'u integruar në BE. Suksesi apo dështimi në luftën kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë, si dhe në të gjithë segmentet e tjerë të sektorit publik do të zgjerojnë ose ngushtojnë hapësirat për respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Forcimi i rolit të shoqërisë civile. Thellimi i procesit të integritetit të Shqipërisë në BE do të shoqërohet me një rritje të përgjegjësive dhe të rolit të shoqërisë civile në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, duke qenë se ky rol në rritje i shoqërisë civile është pjesë e pandashme e procesit të integritetit në BE. Një bazë të mirë për forcimin e rolit të shoqërisë

civile krijoi dhe miratimi gjatë vitit 2014 i ligjeve “Për të drejtën e informimit” dhe “Për konsultimin publik”. Në këtë aspekt, hap i rëndësishëm do të jetë edhe krijimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, i cili pritet të krijohet brenda në fillim të vitit 2016. Ky Këshill do të jetë forumi më i lartë i ndërveprimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile për çështje me interes të përbashkët. Rritja e rolit dhe përgjegjësisë së shoqërisë civile në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në vend krijon mundësi gjithnjë e më të mëdha që shoqëria civile të bëhet aktor kryesor në mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri .

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Këto zgjedhje, të cilat do të mbahen në kontekstin e pritshmërive lidhur me hapjen e negociatave për integrimin e Shqipërisë në BE, do të jenë veçanërisht të rëndësishme për konsolidimin e standardeve për zgjedhje të lira e të ndershme në Shqipëri, por edhe për të shënuar një hap të qartë përpara në drejtim të shkëputjes reale të institucioneve politike nga krimi dhe korrupsioni. Këto zgjedhje mund të jenë edhe një mundësi e mirë për t’i dhënë fund klimës tejte konfliktuale në jetën politike në vend dhe për të ndërtuar një marrëdhënie më konstruktive mes pozitës dhe opozitës, duke qenë se ky është një apel i përsëritur nga BE, por edhe një pritshmëri në rritje nga shumica e qytetarëve.

E ardhme e paqartë në zhvillimin ekonomik. Shqipëria është tashmë në një periudhë anemike të zhvillimit ekonomik, me një rritje prej 3% të PBB të parashikuar për vitin 2015 dhe me një rritje të lehtë në tri vitet në vazhdim². Edhe pse në tri vitet e ardhshme pritet zgjidhja e disa problemeve të rëndësishme lidhur me pronën private (përfundimi i legalizimit të ndërtimeve ilegale, zgjidhja e pronësisë mbi tokën, etj.) është e vështirë të parashikohet një përshpejtim i rritjes ekonomike në Shqipëri, në kushtet e krizës ekonomike në botë dhe rajon, sidomos në dy vende partnere kryesore ekonomike të Shqipërisë si Italia dhe Greqia, në të cilat, po ashtu, punojnë e jetojnë qindra mijëra shqiptarë. Një rritje ekonomike anemike me buxhete të kursyera publike mund të ndikojë negativisht në zgjerimin e respektimit të të drejtave të njeriut, veçanërisht në vënien në dispozicion nga shteti të burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Bashkëpunim më i ngushtë rajonal dhe rritje e rolit të Shqipërisë në rajon. Në dy-tri vitet e fundit vendet e Ballkanit Perëndimor i kanë intensifikuar marrëdhëniet mes tyre, kryesisht si një strategji për të përshpejtuar integrimin e tyre në BE në grup. Ky proces pritet të intensifikohet në tri vitet e ardhshme. Shqipëria është përpjekur të marrë një rol udhëheqës në këtë nismë për një

²<http://data.ëorlbank.org/country/albania>, nxjerrë në 6 tetor 2015

bashkëpunim më të ngushtë rajonal, rol që ka gjasa të forcohet në vitet në vazhdim. Ky bashkëpunim më i ngushtë rajonal krijon mundësi për zgjerimin e bashkëpunimit rajonal mes institucioneve publike, jo qeveritare dhe private, edhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Zhvillimet në BE dhe në rajonet përfaqshues Evropës. Kriza e Euros, e lidhur ngushtë me krizën e rëndë ekonomike në Greqi, Spanjë, Portugali e Itali, si dhe kriza e refugjatëve nga Siria, Afganistani e vende të tjera në konflikt, që vërshuan në BE gjatë vitit 2015, e kanë vënë BE përpara sfidave të forta. Këto kriza dhe pasojat e tyre do të vazhdojnë të ndihen edhe në dy-tri vitet e ardhshme. Konfliktet e armatosura me baza fetare në Afrikën veriore dhe Lindjen e Mesme nuk duken se do të marrin fund së shpejti. Ky proces do të ndikojë ndjeshëm dhe në mënyrë kompleks në qasjen e BE ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor që përpiqen të integrohen në BE. Të gjitha mundësitë janë të hapura: mundësitë që këto kriza ta forcojnë BE-në, por edhe vullnetin e saj për t'u zgjeruar në Ballkan, si dhe mundësitë që këto kriza ta mbyllin BE-në në vetvete e ta zgjasin pa fund procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor në të.

Euroskepticizmi, tensione të mundshme fetare dhe etnike. Krizat, më të cilat përballet BE, një humbje e mundshme e vëmendjes së BE për Ballkanin Perëndimor, si dhe kriza e përzgatur ekonomike, procese këto që ka gjasë të vazhdojnë në një masë të caktuar gjatë tri viteve të ardhshme, mund të fermentojnë rritjen e skepticizmit ndaj BE-së apo të nxisin tensione mbi baza etnike apo fetare në Ballkan. Këto zhvillime do të përkeqësojnë situatën për të drejtat e njeriut në këto vende, efekte që mund të shtriheshin edhe në Shqipëri, sidomos në aspektin e radikalizmit të mundshëm të segmenteve të caktuara shoqërore, ndikuar nga praktika konservatore fetare përballë një modeli në zbatim të një BE-je të pa interesuar për vende si Shqipëria. Këto rreziqe nuk duken krejt pa vend veçanërisht në kuadër të një tendence për kufizimin e të drejtave të njeriut në disa vende të Europës (si Hungaria) apo vende të tjera afër Europës (si Turqia e Azerbajxhani).

Fokusimi i politikave zhvillimore në disa çështjeve 'të reja'. Qëllimet për Zhvillimin e Qendrueshëm, të lançuara nga OKB në shtator 2015³, reflektojnë disa çështje prioritare për botën në vitet e fundit, çështje që janë shpesh në sferën **e të drejtave ekonomiko-shoqërore**

³<https://sustainabledevelopment.un.org/?menu=1300>, nxjerrë më 6 tetor 2015

dhe atyre kolektive - zhvillimore⁴ të njeriut. Mbrojtja e mjedisit, rritja e rolit të grave në vendim-marrje, duke përfshirë sferën ekonomike, rritja e rolit të rinjve në jetën politike, garantimi i të drejtave të plota për komunitete të diskriminuara, si personat LGBTI apo personat me aftësi të kufizuara, janë disa nga këto çështje, të cilat do të jenë të rëndësishme edhe për nismat për mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri në tri vitet e ardhshme.

Zgjerimi i rolit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT) në zhvillimin e vendit. Shqipëria është përfshirë në revolucionin dixhital: shumica e popullsisë ka qasje në internet, përdor platformat online dhe rrjetet sociale, ndërkohë që institucionet publike dhe ato private shtojnë çdo vit volumin e informacionit dhe të shërbimeve që ofrojnë përmes internetit ose celularëve. Kjo tendencë pritet të zgjerohet në tri vitet e ardhshme, për shkak të zgjerimit të përdorimit të celularëve 'të zgjuar' (smart phones), si dhe të uljes së çmimeve të paketave të telefonisë celulare. Ndërkohë, qeveria aktuale është angazhuar në zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve publike përmes internetit ('qeverisja elektronike'), një proces që nisi vullshëm në Shqipëri në vitin 2006. Rritja e përdorimit të ICT në të gjitha sferat e veprimtarisë shënon një mundësi të madhe për përparim në mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ky proces do të shoqërohet edhe me disa sfida që kanë të bëjnë me qasjen në informacion dhe në shërbimet publike përmes internetit për grupet e marginalizuara, si dhe me çështje të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë.

Në fund të vitit 2013, 61% e shqiptarëve kishin qasje në internet.

<http://ëëë.internetëorldstats.com/euroipa2.htm>

⁴<http://ëëë.globalization101.org/three-generations-of-rights/>

IV. Drejtimi strategjik

a. Vizioni

KSHH beson dhe punon për arritjen e një faze zhvillimi të shoqërisë shqiptare ku qytetarët, pavarësisht nga veçoritë, ose dallimet midis tyre ushtrojnë lirisht dhe në mënyrë të njëjtë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare, në të gjitha aspektet e jetës.

KSHH beson se përparimi në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin në praktikë të të drejtave të njeriut realizohet përmes angazhimit dhe bashkëpunimit konstruktiv mes qytetarëve, si dhe mes tyre dhe institucioneve të tjera publike, private dhe jofitimprurëse që besojnë në këtë vizion.

b. Misioni

Misioni i KSHH është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Mandati i KSHH-së në kuadër të përmbushjes së misionit është:

- i. Të informojë dhe sensibilizojë qytetarët shqiptarë dhe të gjithë aktorët e tjerë për të drejtat dhe liritë e tyre;
- ii. Të monitorojë, të avokojë dhe të mbrojë, në mënyrë proaktive, së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri e më gjerë;
- iii. Të përgatitë raporte alternative për zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri;
- iv. Të ofrojë oponencë ligjore dhe ekspertizë për përmirësimin e legjisllacionit dhe harmonizimin e tij me “acquis communautaire” të BE, si dhe zbatimin e tij në praktikë, duke rivendosur të drejtat e shkelura;
- v. Të ofrojë shërbim ligjor falas, në kuadër të litigimit strategjik, në ndihmë të viktimave që u janë shkelur të drejtat e njeriut;
- vi. Të ndihmojë në forcimin e shtetit të së drejtës nëpërmjet zbatimit më të mirë të legjisllacionit në fuqi, forcimit të kapaciteteve të administratës publike dhe ushtrimit të presionit ndaj saj, me mjete demokratike;
- vii. Të nxitë llogaridhënien e administratës publike në zbatimin korrekt dhe efektiv të legjisllacionit nëpërmjet denoncimit publik të cenimit të lirive dhe të drejtave të njeriut,

ose shkeljeve të kryera dhe, sipas rastit dhe kompetences, referimit të tyre tek organet e drejtësisë;

- viii. Të luajë rol aktiv në gjirin e shoqërisë civile për të nxitur përfshirjen e pjesëmarrjen e shtetasve në çështje me interes publik.

c. Vlerat

KSSH e bazon punën e tij në vlerat në vijim:

Përkushtimi ndaj misionit të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, të udhëhequr nga respektimi i standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe nga respekti për dinjitetin e çdo qenieje njerëzore;

Pavarësia nga qendrimet politike partiake, duke mos pranuar financime nga institucione partiake dhe shtetërore, si dhe duke mos përkrahur interesa të ngushta të partive politike;

Integriteti profesional dhe njerëzor i punës, i punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të ngushtë të KSHH, të cilët japin shembullin individual si qytetarë që zbatojnë ligjin dhe promovojnë respektimin e të drejtave të çdo qytetari;

Profesionalizmi që do të thotë se e gjithë puna e KSHH për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, hulumtimin e shkeljeve të tyre dhe kërkimin e rrugëve për adresimin e këtyre shkeljeve bazohet në fakte, në fakte të sakta dhe të marra nga burime të ndryshme ose të verifikuara nga stafi i organizatës, në metodologji të standarteve ndërkombëtare, si dhe udhëhiqet nga standartet më të larta të etikës profesionale;

Transparenca që do të thotë se KSHH e kryen punën e tij në përputhje me ligjet në fuqi, në pajtim me standartet më të përparuara të mirëqeverisjes si organizatë jofitimprurëse dhe ofron qasje të pakufizuar në informacionin që lidhet me punën e tij, duke marrë në konsideratë kufizime që burojnë nga e drejta e privatësisë së viktimave, të shkeljeve të së drejtave të njeriut, etj;

Fokusimi në ndikimin që puna e KSHH ka në përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri e më gjerë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë dhe duke trajtuar me respekt të plotë viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut;

Bashkëpunimi me të gjithë qytetarët, bashkëpunëtorët dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në sektorin e shoqërisë civile, sektorin publik, sektorin privat dhe atë akademik, për të rritur ndikimin e nismave të KSHH në të mirë të mbrojtjes, promovimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut për çdo qytetar në Shqipëri.

Përfshirja e perspektivës gjinore në të gjithë punën e KSHH për të adresuar nevojat, interesat dhe qasjet e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve në kuadër të mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut.

d. Përparësitë konkurruese

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të mundësive dhe sfidave të brendshme dhe të jashtme për arritjen e qëllimeve strategjike të KSHH në tri vitet e ardhshme. Kjo analizë i shërben në mënyrë të veçantë përcaktimit realist të qëllimeve strategjike dhe aktiviteteve të planifikuara për vitet 2016 – 2018.

Pikat e forta të KSHH	Sfidat e brendshme të KSHH
<ul style="list-style-type: none"> • Reputacioni i mirë i KSHH, i njohur për profesionalizëm, paanësi, objektivitet dhe seriozitet; • Përvojë e gjatë në punën me të drejtat e njeriut në Shqipëri; • Stafi i KSHH: larmi për nga mosha, gjinia, dhe arsimi; kombinimi mes punonjësve me kohë të plotë e atyre me kohë të pjesshme; rrjeti i gjerë prej 200 ekspertësh e bashkëpunëtorësh; angazhimi i studentëve. • Transparenca e punës dhe financave të KSHH; • Gëzon besim nga përfituesit e punës së tij; • Marrëdhëniet pozitive me partnerët vendas e ndërkombëtarë, brenda e jashtë vendit; • Marrëdhënie konstruktive me Gjykatën Kushtetuese dhe Parlamentin; • Akses në institucione të mbyllura si institucionet e burgimit, paraburgimit e komisariate te policisë; • Trajtimi i të drejtave të njeriut me shumë mjete e këndvështrime: që nga monitorimi i respektimit të tyre deri tek ofrimi i ndihmës ligjore falas për viktimat; 	<ul style="list-style-type: none"> • Funkcionimi jo gjithnjë me efikasitet i strukturave vendim-marrëse të KSHH; • Të qenit jo aq sa duhet pro-aktiv në raportet me organizatat e institucionet partnere brenda e jashtë vendit; • Marrëdhënie jo e stukturuar me mediat; • Mungesë e burimeve financiare të qendrueshme; • Fokusimi në disa fusha të të drejtave të njeriut, duke lënë jashtë disa të tjera që mund të jenë më aktuale; • Ngarkesa e madhe e punës në raport me burimet njerëzore në dispozicion të KSHH; • Nevojë për kualifikim të mëtejshëm të stafit; • Prezantimi jo gjithnjë efektiv e tërheqës i rezultateve të punës së KSHH; • Larmi relativisht e kufizuar e mjeteve të avokimit që KSHH vë në përdorim.

<ul style="list-style-type: none"> • Forma organizative e mirë: shoqatë; • Kapacitete shumë të mira analitike dhe hulumtuese të stafit dhe ekspertëve; • Financim relativisht i shëndoshë: akumulimi i disa rezervave financiare; • Procedura të qarta të menaxhimit të KSHH dhe zbatim i mirë i tyre; • Vizibilitet relativisht i lartë i punës së KSHH në publik. 	
Sfida në mjedisin, në të cilin vepron KSHH	Mundësi për punën e KSHH
<ul style="list-style-type: none"> • Mjediset me qera; • Konkurrencë nga shërbimi ligjor falas i Ministrisë së Drejtësisë; • Rreziku i kufizimit të mundësisë për monitorim të institucioneve publike; • Rreziku i kufizimit të aksesit në disa institucione publike edhe për shkak të kapacitetit të kufizuar të administratës publike; • Rreziku për regres në konsolidimin e arritjeve në raport me administratën publike, si, p.sh., me prokurorinë, nëse stafi i këtyre institucioneve ndryshon; • Ndryshimet e mundshme të stafit të KSHH; • Vështirësi në sigurimin e fondeve: disa donatorë largohen nga Shqipëria, ndërkohë që thellohet procesi i integritetit në BE, si dhe klientelizmi i disa donatorëve; • Mediatizim i dobët i çështjeve, për të cilat punon KSHH, për shkak të mungesës së interesit të medias dhe politizimit të saj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Sfidat rajonale e globale ekonomike, politike dhe fetare që theksojnë nevojën për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut; • Përparimi në integrimin e Shqipërisë në BE; • Thellimi i reformës në drejtësi; • Axhenda 2025 e OKB-së e adoptuar nga Shqipëria në nëntor 2015; • Thellimi i reformës në administratën publike; • Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre të grupeve të diskriminuara si personat LGBTI dhe Romët; • Theksi në luftën kundër korrupsionit; • Rritja e shtrirjes së ICT duke përfshirë rrjetet sociale; • Vënia në zbatim e ligjit për të drejtën e informacionit dhe atij për pjesëmarrjen e publikut.

V. Objektivat strategjikë dhe programet për vitet 2016 – 2018

Objektivat strategjikë dhe programet e KSHH të paraqitura në këtë seksion të Planit Strategjik reflektojnë: (i) vizionin, misionin dhe vlerat e KSHH; (ii) analizën e faktorëve kyç në kontekstin politik, ekonomik dhe shoqëror që do të ndikojnë në mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri në tri vitet e ardhshme; (iii) analizën e përparësive konkurruese të KSHH; dhe (iv) njohuritë mbi planet e organizatave të tjera të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe programeve ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Gjatë periudhës 2016 – 2018, KSHH do të punojë për të arritur këto objektiva strategjikë:

1. Nivel më i lartë i njohurive të publikut lidhur me gamën e gjerë të të drejtave të njeriut;

2. Kuadër ligjor më i përmirësuar për të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë në të drejtën për jetën, të drejtën për jetë familjare, të drejtën për proces të rregullt ligjor, të drejtën e votës, dhe të drejtën për të jetuar i lirë nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor;
3. Përmirësime konkrete në respektimin dhe zbatueshmërinë, pa diskriminim, të të drejtës për jetën, të drejtës për jetë familjare, të drejtës për proces të rregullt ligjor, të drejtës së votës, dhe të drejtës për të jetuar i lirë nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor, veçanërisht për shtresat në nevojë, të miturit, personat LGBT dhe gratër;
4. Forcimi i qëndrueshmërisë së KSHH.

Gjatë periudhës 2016 – 2018, KSHH do të ndërmarrë programet në vijim për të përmbushur objektivat e tij strategjikë. KSHH do t'i zbatojë këto programe duke vënë në përdorim të gjitha metodat e tij të punës të përmbledhura në seksionin II.c të këtij Plani Strategjik.

Program 1: Edukimi Publik për liritë dhe të Drejtat e Njeriut

Nevoja: Edukimi i publikut dhe i segmenteve të veçanta të tij, që konsiderohen shtresa në nevojë, lidhur me të drejtat e njeriut vuan nga tri probleme: (i) është i pamjaftueshëm, pasi ekziston ideja se ky edukim është ezauruar tashmë në vitet e parë të tranzicionit në demokraci; (ii) nuk është i institucionalizuar si duhet, sepse mungojnë programe për trajnimin e vazhdueshëm për administratën publike dhe në sistemin e arsimit të mesëm e të lartë, ashtu dhe për shtetas të interesuar; (iii) vuan nga një konceptim i kufizuar i të drejtave të njeriut vetëm si të drejta qytetare-politike, duke injoruar të drejtat ekonomiko-shoqërore dhe ato kolektive-zhvillimore; (iv) subjekte të ndryshme zhvillojnë trajnime ose fushata të shkurtra edukimi publik lidhur me të drejta te grupeve të veçanta, por mungon perspektiva komplekse e të drejtave të njeriut në tërësi.

Grupet kryesore në fokus: Nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët; shtresat në nevojë të shtetasve, punonjësit e administratës publike; punonjësit e policisë dhe të burgjeve; ojf-të dhe mediat.

Fokusi gjeografik: Qytetet ku ka universitete; administrata publike qendrore dhe punonjësit në bashkitë prioritare për punën e KSHH.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë:

- ❖ Prezantime dhe diskutime me studentë dhe nxënës të shkollave të mesme;
- ❖ Konkursi “Të Drejtat e Mia” me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të mesme;
- ❖ Fushatë e edukimit publik përmes rrjeteve sociale lidhur me të drejtat e njeriut;
- ❖ Avokim për përfshirjen e një moduli të plotë trajnimi mbi të drejtat e njeriut në programet e trajnimit për punonjësit e administratës publike, të policisë dhe të burgjeve;
- ❖ Avokim për përfshirjen e një moduli të plotë mbi të drejtat e njeriut në curricula universitare në degët e reja;
- ❖ Ofrimi i ndihmës teknike për përgatitjen e moduleve të mësipërme.
- ❖ Avokim dhe bashkëpunim për hapjen e një shkolle verore, ose kurseve të shkurtra formues për të drejtat e njeriut.

Program 2: Mbrojtja dhe Forcimi i Respektimit të së Drejtës për Jetën

Nevoja: E drejta për jetën, e cila përfshin një gamë të gjerë çështjesh (të drejtat riprodhuese, siguria e jetës, kushtet e punës, kontrolli i cilësisë së ushqimeve, etj.) ka një ndikim vendimtar në jetën e çdo njeriu. Kjo është një fushë e të drejtave, e cila deri më sot është trajtuar ngushtë në Shqipëri, ndërkohë që vëmendja e institucioneve ndërkombëtare, duke përfshirë OKB, ndaj këtij grupi të drejtash është rritur shumë në vitet e fundit.

Grupet në fokus: Të gjithë qytetarët dhe institucionet publike përgjegjëse, mediat.

Fokusi gjeografik: Institucionet e qeverisjes qendrore; qytetarët në bashkitë prioritare për veprimtarinë e KSHH⁵.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë:

- ❖ Avokimi në bashkëpunim me organizatat për të drejtat e grave lidhur me përmirësimin e legjislacionit për të drejtën riprodhuese, për të përfshirë adresimin e abortit selektiv mbi baza gjinore dhe teknikat e reja të fertilitetit;
- ❖ Avokim në bashkëpunim me organizatat për mbrojtjen e mjedisit lidhur me përmirësimin e legjislacionit dhe praktikave për të garantuar informimin e publikut lidhur me problemet mjedisore dhe mbrojtjen e shëndetit nga faktorët ndotës të mjedisit e produktet problematike ushqimore;

⁵ Këto janë, në rradhë të parë, shtatë bashkitë ku punojnë korrespondentët e KSHH.

- ❖ Ndjekja e rasteve të litigimit strategjik në lidhje me këtë të drejtë;
- ❖ Edukim dhe sensibilizimi publik lidhur me gamën e gjerë të të drejtës për jetën;
- ❖ Ndërtimi i kapaciteteve në KSHH për t'u marrë me çështje 'të reja' në fushën e të drejtës për jetën, si siguria e jetës dhe e drejta për mjedis të pastër.

Program 3: Mbrojtja dhe Zgjerimi i Respektimit të të Drejtës për Proces të Rregullt Ligjor

Nevoja: E drejta për proces të rregullt dhe ankimim është një nga të drejtat themelore të njeriut që shkelet më shpesh në Shqipëri. Ndërkaq, reforma në drejtësi, e cila është përshkallëzuar gjatë vitit 2015, krijon një mundësi unike për të përmirësuar kuadrin ligjor për këtë të drejtë dhe zbatimin e saj me efikasitet.

Grupe në fokus: Ministria e Drejtësisë dhe Parlamenti; personat, të cilëve ju shkelet e drejta për proces të rregullt ligjor, organet e drejtësisë.

Fokusi gjeografik: Në nivel të institucioneve të qeverisjes qendrore; personat në fokus në bashkitë prioritare për punën e KSHH.

Drejtimit kryesore të veprimtarisë:

- ❖ Ndhimë teknike për institucionet qeveritare përkatëse dhe Parlamentin lidhur me reformën në drejtësi, duke përfshirë amendimet e Kushtetutës, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimet e nevojshme në legjislacionin procedural;
- ❖ Avokim për përmirësimin e qasjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë aksesin në prokurori, shpejtësinë në gjykim, mbrojtjen pa pagesë për personat në nevojë dhe uljen e tarifave gjyqësore; luftimin e fenomenit të korrupsionit në organet e drejtësisë
- ❖ Konsulenca ligjore falas e ofruar nga KSHH për personat, të cilëve ju shkelet e drejta për proces të rregullt dhe ankimim. Litigime strategjik në këtë fushë
- ❖ Rritja e kapaciteteve të stafit të KSHH lidhur me këtë të drejtë e zbatimin e saj në praktikë.

Program 4: Mbrojtja dhe Zgjerimi i Respektimit të së Drejtës për Jetë Familjare

Nevoja: Trajtimi ligjor e në praktikë i të drejtës për jetë familjare është mjaft i kufizuar në Shqipëri. Disa çështje të mëdha si të drejtat e fëmijëve, veçanërisht të komunitetit Rom, të personave LGBTI, të personave të moshës së tretë, apo mbrojtja e privatësisë janë gati krejt

jashtë vëmendjes së institucioneve publike përgjegjëse, por edhe të organizatave të shoqërisë civile, ndërkohë që disa nga këto grupe shoqërore, si, p.sh., moshë e tretë, janë një grup në rritje. Ndërkaq, reforma në drejtësi krijon mundësinë për të përmirësuar disa dokumente kryesorë ligjorë që lidhen me të drejtën familjare.

Grupet kryesore në fokus: Fëmijët, personat LGBTI, moshë e tretë, të rinjtë, duke ju kushtuar vëmendje të veçantë komunitetit rom , emigrantëve dhe të varfërve.

Fokusi gjeografik: Në nivel të institucioneve të qeverisjes qendrore; grupet në fokus në bashkitë prioritare për punën e KSHH.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë:

- ❖ Avokim në bashkëpunim me organizata të tjera lidhur me nevojën për të rishikuar Kodin e Familjes dhe ligje të tjera me fokus tek rregullimi ligjor i martesës i institucionit të kujdestarisë dhe institute të tjera që lidhen me të mitur;
- ❖ Ndhimë teknike për ministritë përkatëse dhe Parlamentin lidhur me rishikimin e Kodit të Familjes dhe të ligjeve të tjera, si dhe kuadrin ligjor për privatësinë;
- ❖ Fushatë edukimi publik lidhur me të drejtën për jetë familjare përmes rrjeteve sociale dhe tryezave të rrumbullakëta me grupet në fokus, si dhe median;
- ❖ Ofrimi i ndihmës ligjore, nëpërmjet litigimit strategjik, për raste të cenimit të të drejtës për jetë familjare

Program 5: Mbrojtja dhe Zgjerimi i Respektimit të së Drejtës së Votës

Nevoja: Përmirësimi i standardeve për të siguruar zgjedhje të lira e të ndershme mbetet një imperativë themelore për demokracinë shqiptare, duke qenë se ende ka probleme të rëndësishme që përsëriten nga një palë zgjedhje në tjetrën. KSHH ka një përvojë të pasur në këtë fushë. Është e nevojshme që nismat lidhur me këto probleme të bëhen më efektive dhe të zgjerohet fusha e veprimit të së drejtës së qytetarit për votën e lirë, duke përfshirë ushtrimin e të drejtës për referendum dhe ndarjen e të zgjedhurve nga krimi.

Grupet ne fokus: Parlamenti, administrata zgjedhore; bashkitë; të rinjtë; emigrantët; të burgosurit; njerëzit me aftësi të kufizuara.

Fokusi gjeografik: Institucione të qeverisjes qendrore; bashkitë me prioritet për punën e KSHH.

Drejtimit kryesore të veprimtarisë:

- ❖ Udhëheqja e punës për garantuar një vlerësim të pavarur nga shoqëria civile të kandidatëve për deputetë nga perspektiva e integritetit të tyre njerëzor dhe profesional;
- ❖ Ndihmë teknike për Parlamentin dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të përmirësuar procesin zgjedhor, duke përfshirë përmirësimet në Kodin Zgjedhor, si dhe depolitizimin dhe rritjen e profesionalizmit të administratës zgjedhore;
- ❖ Monitorim dhe hulumtim lidhur me nevojën dhe potencialin për ushtrimin e së drejtës së votës dhe asaj për referendum;
- ❖ Avokim për përmirësimin e bazës ligjore lidhur me ushtrimin e të drejtës së votës dhe asaj për referendum;
- ❖ Fushatë edukimi publik në bashkitë prioritare për punën e KSHH lidhur me përdorimin e referendumit në nivelin e qeverisjes vendore;
- ❖ Avokimi së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile lidhur me votimin e emigrantëve dhe përmirësimin e kushteve për pjesëmarrjen në votime të njerëzve me aftësi të kufizuara dhe të të burgosurve;
- ❖ Monitorimi i zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017, përgatitja e raportit me gjetjet e rekomandimet përkatëse.

Program 6: Parandalimi dhe Mbrojtja nga Tortura dhe Trajtimi Çnjerëzor

Nevoja: Shqipëria ka bërë përparim në mbrojtjen e qytetarëve nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor. Por, kjo shkelje e të drejtave të njeriut mbetet ende problem në disa institucione publike të mbyllura, duke përfshirë komisariatet e policisë, burgjet, para-burgimet dhe spitalet psikiatrike. Viktima të këtyre shkeljeve janë veçanërisht grupet diskriminuara në Shqipëri, si, për shembull, viktimat e trafikimit, personat LGBT, romet, apo njerëzit me aftësi të kufizuara, ndaj këto grupe meritojnë vëmendje të veçantë dhe të vazhdueshme. KSHH ka një përvojë të gjatë në ofrimin e mbrojtjes për këto kategori.

Grupet në fokus: Burgjet, komisariatet e policisë, para-burgimi, spitalet psikiatrike, ushtria, pikat e grumbullimit të emigrantëve, strehimoret për viktimat e trafikimit, romët dhe personat LGBT, të miturit e gratë.

Fokusi gjeografik: Në nivel kombëtar.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë:

- ❖ Hulumtim për rishikimin e legjislacionit lidhur me këto çështje, sipas sugjerimeve të Gjykatës së Strasburgut: për të përfshirë trajtimet çnjerëzore edhe jashtë institucioneve publike (mësuesit në një shkollë private, për shembull); për të adresuar probleme në fusha të reja; si dhe për të fuqizuar parandalimin e shkeljes së të drejtave në këtë fushë përmes masave të tërthorta dhe të drejtpërdrejta;
- ❖ Përgatitja e raporteve alternative për Këshillin e Evropës dhe Komitetin për të Drejtat e Njeriut në OKB lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut në këtë fushë;
- ❖ Ofrimi i ndihmës ligjore falas për viktimat e torturës dhe trajtimit çnjerëzor, nëpërmjet formave të punës së litigimit strategjik;
- ❖ Ofrimi i ndihmës teknike dhe trajnimeve për punonjës të sistemit të drejtësisë dhe institucione të tjera që lidhen me të drejtën për t'u mbrojtur nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor;
- ❖ Monitorimi i institucioneve të burgimit, paraburgimit, spitaleve psikiatrike dhe komisariateve të policisë, si dhe përgatitja e raporteve e bërja publike e gjetjeve dhe rekomandimeve të tyre.

Program 7: Forcimi i Qendrueshmërisë dhe Eficencës së Organizatës

Nevoja: Nevoja për një punë më të gjerë dhe më të specializuar në fushën e mbrojtjes, promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut do të rritet në kuadër të thellimit të demokracisë në Shqipëri, si dhe të përsheptimit të procesit të integritetit të vendit në BE. Nevojat për kontributin e KSHH si organizatë udhëheqëse në fushën e të drejtave të njeriut në Shqipëri do të jenë në rritje, po ashtu, ndërkohë që zgjerohet fusha e të drejtave të njeriut që bëhen të rëndësishme për qytetarët shqiptarë. Ndërkaq, natyra e burimeve të financimit për organizata që punojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut mund të ndryshojë shpejt, duke qenë se burimet e financimit nga BE do të marrin përparësi gjithnjë e më shumë. Duke marrë në konsideratë këtë kontekst dinamik dhe këtë plan strategjik ambicioz, KSHH ka nevojë të forcojë qëndrueshmërinë dhe të modernizojë funksionimin e tij.

Fokusi gjeografik: KSHH në Tiranë dhe bashkëpunëtorët e tij në bashki të ndryshme

Drejtimet kryesore të veprimtarisë:

- ❖ Kryerja e një vlerësimi të kapaciteteve organizative dhe vendim-marrëse të KSHH;
- ❖ Riorganizimi dhe rinovimi i strukturave vendim-marrëse të KSHH, me qëllim forcimin e bashkëpunimit e ndërveprimit më të mirë midis tyre;
- ❖ Hartimi dhe zbatimi i një plani për trajnimin e kualifikimin e mëtejshëm dhe promovimin e stafit të KSHH;
- ❖ Hartimi dhe zbatimi i një plani për sigurimin e fondeve në mbështetje të zbatimit të këtij Plani Strategjik dhe për fuqizimin e fondit rezervë të KSHH;
- ❖ Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e projekteve të financuara nga donatorë të mëdhenj dhe të projekteve rajonale
- ❖ Përgatitja dhe zbatimi i një Plani për Informim të KSHH me fokus në modernizmin dhe zgjerimin e marrëdhënieve me publikun dhe të punës për edukimin e publikut, duke përfshirë përdorimin më të gjerë dhe më efikas të ICT.
- ❖ Forcimi i kapaciteteve dhe mjeteve për marrëdhënie më efikase me publikun.

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

KSHH i kushton një rëndësi të veçantë vlerësimit dhe monitorimit të veprimtarisë së tij. Drejtorja Ekzekutive mbikqyr punën për vlerësimin dhe monitorimin efektiv të veprimtarisë së KSHH, ndërsa Përgjegjesit e Programeve të KShH janë përgjegjës/e për zbatimin e të gjitha planeve për vlerësim e monitorim të programeve dhe projekteve të KSHH.

KSHH do të monitorojë punën për zbatimin e Planit Strategjik 2016 – 2018 kryesisht përmes aktiviteteve në vijim:

- i. Hartimi dhe Zbatimi i Planit për Vlerësim dhe Monitorim (PVM) në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të organizatës, mbështetur në mënyrë të veçantë nga Civil Rights Defenders dhe donatorë të tjerë;
- ii. Përgatitja dhe zbatimi i planeve të vlerësimit dhe monitorimit për çdo program apo veprimtari të financuar nga donatorët, në përputhje me kërkesat për vlerësim e monitorim të donatorit përkatës;
- iii. Përgatitja dhe paraqitja tek donatorët e raporteve për veprimtarinë e KSHH në zbatim të çdo projekti, sipas kalendarit dhe kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen e grantit me donatorin përkatës;
- iv. Përgatitja e raporteve vjetore për veprimtarinë e KSHH dhe paraqitja e tyre për shqyrtim dhe miratim fillimisht nga Bordi Drejtues e më pas nga Asambleja e Përgjithshme e KSHH;
- v. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për treguesit e PVM në një bazë elektronike të përqendruar të dhënash;
- vi. Kryerja e një vëzhgimi vjetor (përmes SurveyMonkey) lidhur me mendimet e sugjerimet e bashkëpunëtorëve dhe përfituesve të KSHH për përmirësimin e punës së Komitetit;
- vii. Përgatitja e historive të suksesit që ilustrojnë ndikimin konkret të punës së KSHH në përmirësimin e mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri.
- viii. Kryerja e auditimeve financiare vjetore nga kompani të specializuara të çdo projekti të zbatuar nga KSHH, si dhe të gjithë veprimtarisë financiare të Komitetit.